

**PROGRAMI I PUNËS SË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

JANAR – DHJETOR 2022



**MIRATOI**

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

**ZYRA E KOMISIONERIT**



<b>OBJEKTIVI</b>	<b>MASAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>PERIUDHA</b>	<b>REZULTATI</b>
Hartimi i Raportit Vjetor 2021.	<p>Bashkërendim institucional me qëllim mbledhjen e informacioneve dhe statistikave në lidhje me veprimtarinë vjetore institucionale.</p> <p>Përgatitja e Raportit Vjetor 2021.</p> <p>Depozitimi i Raportit Vjetor 2021 në Kuvendin e Shqipërisë dhe diskutimi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.</p>	3 mujori i parë i vitit	Raporti Vjetor 2021, i miratuar.
	<p>Miratimi i Raportit Vjetor 2021 dhe Rezolutës për veprimtarinë e institucionit nga Kuvendi i Shqipërisë.</p>	3 mujori i dytë i vitit	Rezolutë për veprimtarinë e institucionit nga Kuvendi i Shqipërisë, e miratuar.
Hartimi i Strategjisë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2022-2024.	<p>Vlerësimi i sugjerimeve të ekspertëve të projektit të binjakëzimit dhe përshtatja e tyre në Strategji.</p> <p>Hartimi i Strategjisë Institucionale 2022-2024.</p>	3 mujori i parë i vitit.	Strategjia për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2022-2024, e miratuar.

	<p>Hartimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Institucionale 2022-2024.</p> <p>Miratimi i Strategjisë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2022-2024 dhe Planit të Veprimit të saj.</p>	3 mujori i dytë i vitit.	
Hartimi i Planit të Integritetit 2022 – 2024.	<p>Ngritja e grupit të punës për zbatimin e bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për hartimin e Planit të Integritetit në kuadër të projektit “<i>Forcimi i integritetit publik</i>”.</p> <p>Hartimi i Planit të Veprimit të menaxhimit të Riskeve.</p> <p>Miratimi i Planit të Integritetit 2022 – 2024.</p>	<p>3 mujori i parë i vitit</p> <p>3 mujori i parë i vitit</p> <p>3 mujori i dytë i vitit</p>	Plani i Integritetit 2022 – 2024, i miratuar.
28 Janar 2022 – Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.	<p>Nënshkrimi i protokollit ndryshues të Konventës 108/1981 “<i>Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale</i>” dhe Konventës 205/2009 “<i>Mbi aksesin në dokumentet zyrtare</i>” të KiE, nga Ambasadori i Shqipërisë në Këshillin e Evropës.</p> <p>Prezantimi i iniciativës së një pyetësoi për kontrolluesit publik (<i>autoritete publike</i>) që përpunojnë të dhëna personale të qytetarëve.</p> <p>Vlerësimi i njohurive të administratës publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, kriterëve dhe normave për përpunimin e ligjshëm të tyre.</p>	<p>3 mujori i parë i vitit (28.01.2022)</p> <p>3 mujori i parë i vitit</p>	<p>Konventa 108 + dhe Konventa 205 të nënshkruara.</p> <p>Qytetarë të informuar mbi standardet ndërkombëtare në dy fushat e veprimtarisë.</p> <p>Krijimi i një panorame mbi nivelin e njohjes nga sektori publik i detyrimeve të ligjit nr. 9887/2008 “<i>Për mbrojtjen e të dhënave personale</i>”, dhe evidentimi i nevojave për zhvillim profesional dhe trajnime të mëtejshme të nëpunësve të këtyre institucioneve.</p>

28 Shtator 2022 – Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim.	Organizim i aktivitetit ndërgjegjësues për qytetarët me qëllim ushtrimin aktiv të së drejtës për t'u njohur me informacion publik, nëpërmjet zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.	3 majori i tretë i vitit (28.09.2022)	Qytetarë të informuar dhe ndërgjegjësuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre.
Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.	<p>Institucionalizimi i bashkëpunimit me anë të një marrëveshjeje bashkëpunimi.</p> <p>Identifikimi i formave të qendrueshme dhe efektive të bashkëpunimit, në përputhje me kompetencat përkatëse institucionale, me qëllim promovimin e nismave për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe transparencës.</p> <p>Organizimi i aktiviteteve me fokus rritjen e transparencës, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtës për informim, si dhe nxitjen e integritetit dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.</p> <p>Angazhim i Zyrës së Komisionerit për t'i ofruar Ministrisë së Drejtësisë, mbështetje profesionale të dobishme për rritjen e kapaciteteve, veçanërisht, sa i përket programit të transparencës për institucionet pjesë e Rrjetit Antikorrupsion.</p>	6 majori i dytë i vitit	<p>Marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar.</p> <p>Institucione transparente dhe me integritet në llogaridhënie.</p>
Bashkëpunime dhe trajnime me Institucione të Arsimit të Lartë në qytete të ndryshme të vendit.	<p>Korrespondencë dypalëshe.</p> <p>Ftesë për pjesëmarrje dhe plotësim pyetësori.</p> <p>Organizimi i aktivitetit, përzgjedhja e tematikave dhe pjesëmarrësve.</p> <p>Certifikimi i pjesëmarrësve.</p>	Gjatë vitit	Studentë dhe staf akademik/administrativ i trajnuar.

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

### DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, (në vijim “ligji për të drejtën e informimit”).</p>	<p>Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës të Rishikuar sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020, i ndryshuar i Komisionerit.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Hartimi i akteve përfundimtare.</p> <p>Monitorimi i zbatimit të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018, të Komisionerit.</p> <p>Monitorimi i zbatimit të përmbajtjes së “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 të Komisionerit.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Raport monitorimi vjetor.</p> <p>313 AP<sup>1</sup> të monitoruara.</p> <p>35 AP të inspektuara.</p> <p>Vendime.</p> <p>Rekomandime.</p> <p>Raport monitorimi vjetor.</p> <p>61 NJVV<sup>2</sup> të monitoruara.</p> <p>15 NJVV të inspektuara.</p> <p>Vendime.</p> <p>Rekomandime.</p> <p>Hartimi i Indeksit të Transparencës.</p>

<sup>1</sup> AP – Autoritete Publike

<sup>2</sup> NJVV – Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

<p>Instalimi i Regjistrisë Elektronike të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI).</p>	<p>Komunikim i vazhdueshëm me AP me qëllim instalimin dhe përdorimin e REKPDI.</p> <p>Instalimi i REKPDI nga Zyra e Komisionerit në 100 autoritete të reja publike, duke e çuar në 195 numrin total të institucioneve që e kanë funksional atë.</p> <p>Trajnim i 100 koordinatorëve për të drejtën e informimit për mënyrën e përdorimit të tij.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Regjistër elektronik i instaluar edhe në 100 AP.</p> <p>100 koordinatorë për të drejtën e informimit të trajnuar për mënyrën e përdorimit të REKPDI.</p>
<p>Përmbushja e objektivit të parashikuar në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP) 2018-2022: <i>“Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion”</i>.</p>	<p>Realizimi i masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNRAP 2018-2022.</p> <p>Plotësimi me Program Transparence i të gjitha institucioneve të administratës qendrore.</p> <p>Statistika mbi numrin e institucioneve qendrore me program transparence të miratuar (313 AP qendrore).</p> <p>Statistika mbi numrin e NJVV me programe transparence të miratuara (61 bashki në total).</p> <p>Vënia në funksion të plotë të Regjistrisë Elektronike të Kërkesave dhe Përgjigjeve.</p> <p>Raportim mbi trajnimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit lidhur me përdorimin e Regjistrisë Elektronike Qendrore të Kërkesave dhe Përgjigjeve.</p> <p>Trajnime për forcim kapacitetesh në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nr. i personave të trajnuar.</li> <li>- Nr. i kurseve të trajnimit.</li> </ul>	<p>Gjatë vitit</p> <p>6 maji i parë dhe i dytë i vitit</p>	<p>Përmbushje e objektivit.</p> <p>Raportim pranë strukturave përkatëse përgjegjëse për monitorimin e Planit të Veprimit të SNRAP.</p>

<p>Realizimi i indikatorit të parashikuar në Kontratën e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen.</p>	<p>Realizimi plotësisht i indikatorit 7.2 të parashikuar në këtë kontratë, target i së ciliës për vitin 2022 është: <i>“Të paktën 122 Autoritete Publike të përdorin Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve”</i>.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>122 AP në total të kenë instaluar Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve.</p>
<p>Përmbushja e objektivit të parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Antikorrupsionin (SNKK) 2020 – 2023.</p>	<p>Monitorim i Programit të Transparencës i të gjitha autoriteteve publike.</p> <p>Monitorim program transparence të të gjitha njësiteve të vetëqeverisjes vendore.</p> <p>Krijimi i dy sistemeve të matjes së transparencës dhe llogaridhënies duke përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës.</p> <p>Instalimi edhe në 100 autoritete publike i REKPDI</p> <p>Raportim pranë strukturave përkatëse përgjegjëse për monitorimin e SNKK 2020-2023.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Masat e parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK 2020-2023, të realizuara.</p> <p>Hartimi i Indeksit të Transparencës për institucionet qendrore.</p> <p>Hartimi i Indeksit të Transparencës për NJVV.</p> <p>REKPDI i instaluar edhe në 100 AP.</p>
<p>Ofrimi i shërbimit të kërkesës për informacion publik dhe ankesës për mos dhënie informacioni nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.</p>	<p>Shtirja e shërbimit të kërkesës për informacion publik drejt 100 autoriteteve të tjera dhe trajnimi i koordinatorëve.</p> <p>Bashkëpunim i Zyrës së Komisionerit me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) duke mundësuar trajnimin e koordinatorëve të autoriteteve publike si dhe konfigurimin në sistemin AMS të kredencialeve të koordinatorëve në adresat e-mail të tyre.</p> <p>Fushatë/materiale informuese për qytetarët lidhur me ofrimin e këtij shërbimi nëpërmjet portalit e-Albania.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Ofrimi i shërbimit të kërkesës për informacion publik dhe ankesës për mos dhënie informacioni, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania edhe nga 100 AP të tjera, duke e çuar në 161 numrin në total të AP që ofrojnë këtë shërbim.</p> <p>Qytetarë të informuar lidhur me ofrimin e këtyre shërbimeve nëpërmjet portalit e-Albania.</p>

Përditësimi i portalit pyetshtetin.al	<p>Përditësim i portalit pyetshtetin.al me informacion.</p> <p>Përditësimi i listës dhe emërtimeve të AP në portal.</p> <p>Lidhja me link-un e programit të transparencës së AP.</p> <p>Përditësim i të kontakteve dhe të dhënave të koordinatorëve.</p>	Gjatë vitit	Mirëmbajtja e portalit pyetshtetin.al
Zbatimi i Projektit në bashkëpunim me Ambasadën Britanike	<p>Organizimi i fushatave të brendshme komunikimi dhe angazhimi.</p> <p>Zhvillimi i një strategjie me shumë kanale, mesazhe dhe materiale, si dhe vlerësim.</p> <p>Përfshirja e ideve që kanë funksionuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe përshtatja e tyre në kontekstin në Shqipëri.</p> <p>Raste studimore për proceset dhe zbatimin e programeve të transparencës në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- një NJVV;</li> <li>- një AP qendror.</li> </ul> <p>Zhvillimi i rasteve studimore dhe rishikimi i materialeve ekzistuese dhe gjithashtu zhvillim i përmbajtjes së re, duke përfshirë shembuj.</p> <p>Aktivitete ndërgjegjësuese me autoritetet publike dhe koordinatorët për të drejtën e informimit.</p>	Gjatë vitit	<p>Promovimi dhe ndërtimi i një kulture transparence.</p> <p>Manual për përdorim nga koordinatorët për të drejtën e informimit, i publikuar.</p>
Rritja e kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës për informim.	<p>Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese në AP, për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit.</p> <p>Pjesëmarrje në takime dhe në grupe pune.</p>	Gjatë vitit	<p>Kapacitete të rritura të koordinatorëve.</p> <p>Zbatim më efektiv i ligjit për të drejtën e informimit.</p>

	<p>Takime ndërgjegjësuere në nivel Këshilli Qarku, me përfaqësues të AP qendrore dhe NJVV mbi programet e transparencës dhe detyrimet të cilat burojnë nga ligji për të drejtën e informimit.</p> <p>Komunikim i vazhdueshëm me përfaqësues të AP qendrore si dhe NJVV, si dhe me koordinatorët për të drejtën e informimit mbi programin e transparencës, si dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit.</p>		<p>Shtim i numrit të kërkesave për informacion të përmbushura.</p> <p>12 takime ndërgjegjësuere të realizuara mbi të drejtën e informimit në 12 Këshillat e Qarqeve.</p> <p>10 trajnime të zhvilluara në kuadër të zbatimit të kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit me koordinatorët për të drejtën e informimit në nivel vendor.</p>
<p>Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për qytetarët në lidhje me të drejtat që u burojnë nga ligji për të drejtën e informimit</p>	<p>Zhvillimi i sesioneve informuese në universitete publike dhe private.</p> <p>Përgatitja e <i>Newsletter</i> mujor “<i>E drejta për informim</i>”.</p> <p>Organizimin e disa aktivitete ndërgjegjësuere me përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Shkolla e Avokatisë mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion si dhe zbatimin e detyrimeve të ligjit për të drejtën e informimit.</p> <p>Përgatitja e broshurave, fletëpalosje, video.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Qytetarë të ndërgjegjësuar.</p> <p>Rritje e kërkesave të qytetarëve për të drejtën e informimit.</p> <p><i>Newsletter</i> i publikuar.</p> <p>Aktivitete ndërgjegjësuere të zhvilluara me përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Shkolla e Avokatisë.</p> <p>Video, broshura, fletëpalosje të publikuara.</p>



## DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.	<p>Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Zhvillim i inspektimeve pranë autoriteteve publike.</p>	Gjatë vitit	<p>Vendime.</p> <p>50 Inspektime të kryera.</p> <p>Garantim aksesi në informacion publik për qytetarët.</p> <p>Material përmbledhës i vendimmarrjes kryesore të Komisionerit me qëllim njohjen e kërkuësve dhe AP për qëndrimin e Komisionerit lidhur me informacione/dokumentacione të caktuara publike (material informues/ndërgjegjësues).</p>
Përfaqësimi në proceset gjyqësore në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.	<p>Ndjekja e çdo çështje nga inspektorët.</p> <p>Përgatitja e prapësimeve, autorizimeve dhe ankimimeve.</p> <p>Përfaqësim dhe ndjekja e proceseve gjyqësore.</p>	Gjatë vitit	<p>Tabelë statistikore mbi proceset gjyqësore.</p> <p>Prapësime, konkluzione përfundimtare, ankimime dhe akteve të tjera administrative.</p> <p>Krijim i jurisprudencës për të drejtën e informimit.</p>

## DREJTORIA PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

### DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar me qëllim respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale.</p>	<p>Trajtimi i ankesave të subjekteve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Zhvillimi i hetimeve administrative, iniciuar mbi bazë ankese për verifikimin e mëtejshëm pranë kontrolluesit.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Hartimi i akteve përfundimtare.</p> <p>Kthim përgjigje ankuesit mbi përfundimin e hetimit administrativ.</p> <p>Zhvillimi i trajnimeve dhe veprimtarive ndërgjegjësuese në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me kontrollues të ndryshëm publikë dhe privatë.</p> <p>Kontribut material-ligjor në përpjekjet e përbashkëta ndërsektoriale për harmonizimin e legjislacionit sektorial me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Vendime.</p> <p>Rekomandime.</p> <p>Urdhra.</p> <p>Ankesa të trajtuara.</p> <p>Prezantime, trajnime, ëorkshop. Opinione/mendime.</p> <p>Raporte (të posaçme dhe vjetore).</p>
<p>Vijim i monitorimit të zbatimit të detyrimeve lidhur me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Eurojust.</p>	<p>Kontakti me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Garantimi dhe monitorimi i përmbushjes së legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave</p>

	<p>Zhvillimi i hetimeve administrative pranë prokurorive me qëllim mbikëqyrjen mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimeve që burojnë për mbrojtjen e të dhënave nga Marrëveshja e Bashkëpunimit me Eurojust.</p> <p>Hartimi i draft/raportit vjetor në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave në Eurojust në përmbushje të nenit 19, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust.</p>	Në fund të vitit	<p>personale nga organet e prokurorisë.</p> <p>Raportimi në kuadër të përmbushjes së detyrimit të nenit 19 Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust.</p>
Regjistrimi i kontrolluesve.	Shqyrtimi, mbajtja, administrimi dhe regjistrimi në regjistrin elektronik të Komisionerit, të hapur për publikun i të gjitha njoftimeve.	Gjatë vitit	Transparencë ndaj publikut.
Forcimi i rolit dhe krijimi i <i>Rrjetit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</i> , në kontrollues publik dhe privat.	Ndërtimi i infrastrukturës për të vendosur kanalet e komunikimit ndërmjet nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale me Zyrën e Komisionerit.	Gjatë vitit	Krijimi i regjistrit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave
Përditësimi i regjistrimit të kontrolluesve, subjekt të ligjit nr. 19/2016 <i>“Për masat shitesë të sigurisë publike”</i> .	Regjistrimi i subjekteve të ligjit për masat shitesë të sigurisë.	Gjatë vitit	Zbatim i nenit 21, e në vijim i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatim i pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 19/2016 <i>“Për masat shitesë të sigurisë publike”</i> .
Monitorim dhe mbikëqyrje në kuadër të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.	<p>Shqyrtimi i kërkesave për autorizim të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit;</p> <p>Përgatitja e akteve paraprake dhe përfundimtare që kanë lidhje me shqyrtimin e praktikës së transferimit ndërkombëtar.</p> <p>Këshillim dhe dhënie opinioni ligjor në lidhje me transferimin ndërkombëtar.</p>	Gjatë vitit	<p>Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në kuadër të transferimit ndërkombëtar.</p> <p>Garantim i mbrojtjes së të dhënave personale nga rreziqet e shtuara që mund të paraqes transferimi ndërkombëtar.</p>

	Identifikimi i subjekteve që realizojnë transferim ndërkombëtar dhe realizimi i hetimeve administrative në këta kontrollues.		Vendime për dhënie apo refuzim autorizimi, si dhe orientimi i kontrolluesve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore.
Përfaqësimi në proceset gjyqësore në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.	Ndjekja e çdo çështje nga inspektorët. Përgatitja e prapësimeve, autorizimeve dhe ankimimeve. Përfaqësim dhe ndjekja e proceseve gjyqësore.	Gjatë vitit	Tabelë statistikore mbi proceset gjyqësore. Prapësime, konkluzione përfundimtare, ankimime dhe akteve të tjera administrative. Krijim i jurisprudencës ë fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
Rritja e cilësisë në dhënien e opinioneve ligjore për projekt akte ligjore dhe nënligjore të ardhura për mendim.	Analizimi i projekt akteve ligjore dhe nënligjore të ardhura për mendim në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integritimit.	Gjatë vitit	Mendime dhe opinione ligjore.

#### **DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE**

<b>OBJEKTIVI</b>	<b>MASAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>PERIUDHA</b>	<b>PRODUKTI</b>
Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në sektorët publikë dhe privatë, me fokus ndër të tjera, garantimin e sigurisë teknike dhe organizative të të dhënave, si dhe krijimit, mirëmbajtjes dhe	Monitorim i gjendjes së përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave në kontrollues publikë dhe privatë. Bashkëpunimi me kontrolluesit. Zhvillimi i hetimeve administrative.	Gjatë vitit.	Vendime. Rekomandime. Urdhra. Rritje ose thellim i hetimeve dhe investigimeve të plota

<p>administrimit të SMSI për menaxhimin e sigurinë së informacionit, për të realizuar dhe ruajtur konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit.</p>	<p>Mbajtja e seancave dëgjimore. Hartimi i akteve.</p>		<p>administrative, mbi bazë plani dhe njoftimi. Garantim i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale gjerësisht mbi bazë sektorësh.</p>
<p>Kryerja e hetimeve administrative pranë kontrolluesve që operojnë në këta sektorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sektori i marketingut të drejtpërdrejtë;</li> <li>- sektori i sigurimeve;</li> <li>- sektori call center;</li> <li>- kompanitë private të programimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve që kanë marrëveshje me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;</li> <li>- institucione financiare jobankare;</li> <li>- kontrolluesit e mëdhenj publik që përdorin të dhëna personale të llojit “<i>Big data</i>”.</li> </ul>	<p>Përgatitja e planit për kontrollet që do të ushtrohen.  Kryerja e hetimeve administrative në këta sektorë.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Vendime.  Rekomandime.  Urdhra.  Raporte</p>
<p>Monitorim i rekomandimeve të lëna më herët për kontrollues publik dhe privat në kuadër të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të Rezolutës datë 21.05.2020, të Kuvendit të Republikës</li> </ul>	<p>Analizë e njoftimit të kontrolluesve publikë dhe privatë në adresë të Zyrës së Komisionerit për përmbushjen e rekomandimeve të lëna;</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Rekomandime të përmbushura dhe adresim i problematikës.</p>

<p>së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019”;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Relacionit nr.1399 prot., datë 19.08.2021 “Hetimi Administrativ për Përhapjen e Paligjshme të të Dhënave Personale të Shtetasve” dhe vendimarrjes përkatëse. Detyrë e lënë edhe nga Raporti i Progresit 2021 i Komisionit Evropian për Shqipërinë;</li> <li>- sektorin e shëndetësisë;</li> <li>- sektorin e arsimit.</li> </ul>	<p>Zhvillimi i hetimeve administrative për verifikimin e mëtejshëm të përmbushjes së rekomandimeve nga këta kontrollues.</p>		
<p>Monitorim i organeve ligjzbatuese për detyrat që Zyra e Komisionerit ka në kuadër të ligjeve të tjera të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ligji për masat shtesë të sigurisë publike;</li> <li>- ligji për kontrollin kufitar;</li> <li>- ligji për gjendjen civile;</li> <li>- ligji për policinë e shtetit;</li> </ul>	<p>Monitorim i gjendjes së përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave në kontrollues publikë të fushave përkatëse.</p> <p>Bashkëpunimi me kontrolluesit në kuadër akteve ligjore dhe nënligjore të përbashkëta.</p> <p>Kryerja e hetimeve administrative në sektorët e identifikuar.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Hartimi i një Raporti në kuadër të këtij monitorimi.</p>

## DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
Vijimi i procedurave për miratimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””.	<p>Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë në cilësinë e institucionit propozues të këtyre dy projektligjeve në Këshillin e Ministrave në kuadër të vijimi të mëtejshëm të procedurave ligjore deri në miratimin e tyre.</p> <p>Rol aktiv në diskutimin dhe miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit për të drejtën e informimit, i ndryshuar.</p> <p>Kontribut në hartimin e akteve nënligjore të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>6 mujori i parë i vitit</p> <p>3 mujori i katër i vitit</p>	<p>Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me <i>acquis</i> të BE në këtë fushë, i miratuar.</p> <p>Ligji “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, i miratuar . Akte nënligjore të miratuara.</p>
Ndjekja e procedurave për ratifikimin e Konventës 108+.	Rol aktiv në diskutimin dhe miratimin e Protokollit që ndryshon Konventën e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.	6 mujori i parë i vitit	Ratifikimi i Konventës 108 +.
Ndjekja e procedurave për aderimin në Konventën 205/2009 e Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”.	Rol aktiv në diskutimin dhe miratimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”.	6 mujori i parë i vitit	Aderimi në Konventën 205/2009 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”
Finalizimi i procedurave për miratimin e projektligjit “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i përafuar me Direktivën 2019/1024/BE.	Rol aktiv në diskutimin dhe miratimin e projektligjit “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.	6 mujori i parë i vitit	Ligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i miratuar.

<p>Vijimi i procesit për miratimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara”.</p>	<p>Rol aktiv në diskutimin dhe miratimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara”.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Ligji “Për krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara”, i miratuar.</p>
<p>Përmbushja e objektivave dhe masave të parashikuara në Strategjinë së Edukimit Ligjor të Publikut (SELP) dhe Planit të saj të Veprimit.</p>	<p>Koordinim dhe pjesëmarrje në Komisionin Drejtues dhe Rrjetin e SELP.</p> <p>Koordinim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të SELP.</p> <p>Informimi i plotë i publikut duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit, sidomos bashkëveprim me median në lidhje me zbatimin e SELP.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Raportim në 6 mujorin e parë dhe të dytë të vitit pranë strukturave përgjegjëse monitoruese.</p> <p>Pasqyrim me transparencë i aktivitetit të Zyrës së Komisionerit.</p> <p>Botim/publikim i materialeve informuese dhe/ose ndërgjegjësuese mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit.</p> <p>Botimi i revistës periodike 6-mujore (nr. 13 dhe 14).</p> <p>Faqe zyrtare e përditësuar.</p>
<p>Përgatitja e raportimeve periodike në kuadër të detyrimeve që burojnë nga marrëveshje ndërkombëtare.</p>	<p>Pjesëmarrje dhe raportim i rregullt në Grupin Ndërinstitucional të Punës lidhur me Kapitullin “Kriteri politik”, Kapitullin 10, Kapitullin 23 dhe Kapitullin 25.</p> <p>Përgatitja e Raportimeve për Nënkomitetin Bashkimi Evropian - Shqipëri “Drejtësi, Liri, Siguri” dhe ndjekja e detyrimeve të lëna nga viti paraardhës.</p> <p>Përgatitja e Raportimeve për Nënkomitetin për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik dhe ndjekja e detyrimeve të lëna nga viti paraardhës.</p> <p>Përgatitja e kontributit përkatës në lidhje me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në kuadër të hartimit të Raportit të Shtetit.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Performancë institucionale në përputhje me rekomandimet e lëna nga aktet ndërkombëtare.</p> <p>Rekomandime të lëna për Zyrën e Komisionerit nga aktet ndërkombëtare të përmbushura.</p>



	<p>Përgatitja e raportimeve për strukturat përgjegjëse të ngarkuara me monitorimin e zbatimit të detyrimeve që burojnë nga Raporti i Shtetit për Zyrën e Komisionerit dhe ndjekja e detyrimeve të lëna nga viti paraardhës.</p> <p>Përgatitja e kontributit përkatës të Zyrës së Komisionerit në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian për kapitujt përkatës.</p>		
<p>Ndjekja dhe zbatimi i detyrave që burojnë nga Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018 <i>“Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”</i>.</p>	<p>Përgatitja e Raportimeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Rezoluta e Kuvendit për Zyrën e Komisionerit.</p> <p>Përgatitja e Raportimeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për institucionet e tjera nga Zyra e Komisionerit.</p> <p>Përditësimi i Platformës Ndërinstitucionale të Kuvendit për ndjekjen e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna për institucionet e tjera nga Zyra e Komisionerit.</p> <p>Analizë e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe koordinim me drejtoritë përgjegjëse për përmbushjen e rekomandimeve.</p>	<p>Çdo 4 muaj</p> <p>Çdo 4 muaj</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>6 majori i parë i vitit</p>	<p>Detyrimet e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimi nr. 134/2018 <i>“Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”</i>, të përmbushura.</p> <p>Platforma Ndërinstitucionale e Kuvendit përditësuar.</p>
<p>Trajtimi i ankesave bazuar në parashikimet e ligjit nr. 146/2014 <i>“Për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>.</p>	<p>Shqyrtimi i ankesave.</p> <p>Zhvillimi i seancave dëgjimore.</p> <p>Bashkëpunim me institucionet dhe shoqërinë civile.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Vendim.</p>
<p>Ndjekja e procedurave me zyrën përmbarimore.</p>	<p>Përgatitja e kërkesave për vënien në ekzekutim dhe/ose pushimin e ekzekutimit të vendimeve kontratë shërbimi dhe akteve të tjera administrative.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Vendime të ekzekutuara.</p>

	Mbajtja e korrespondencës me zyrën përmbare.  Përditësimi i listës, mbi ekzekutimin e vendimeve me sanksion gjobë.		
Rishikimi i akteve rregullatore të brendshme të Zyrës së Komisionerit në zbatim të legjislacionit vendas.	Përditësimi dhe hartimi i akteve rregullatorë.	Gjatë vitit	Rregullore/dokumente të brendshme institucionale të përditësuara dhe miratuara.
Përfaqësimi në proceset gjyqësore në zbatim të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe çështje të tjera me objekt të ndryshëm nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligji për të drejtën e informimit	Përgatitja e prapësimeve, autorizimeve dhe ankimimeve. Përfaqësim në proceset gjyqësore.	Gjatë vitit	Prapësime, ankimime, dhe akte të tjera administrative. Ndjekja e seancave gjyqësore.
Forcimi i bashkëpunimit i marrëdhënieve ndërkombëtare të Zyrës së Komisionerit.  Përditësimi i bazës së të dhënave të akteve dhe dokumenteve ndërkombëtare si në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale ashtu edhe të drejtës së informimit.	Komunikimi/korrespondenca me autoritetet homologe dhe shkëmbim informacioni për fushën e veprimtarisë institucionale.  Përditësimi i të dhënave në faqen zyrtare.  Pasurimi me materiale i faqes zyrtare.  Përkthimi i dokumenteve dhe publikimi i tyre.	Gjatë vitit	Forcim dhe njohje e rolit të Zyrës së Komisionerit në planin ndërkombëtar me që qëllim përfitimin nga shkëmbimet që garanton pjesëmarrja në to.  Transparencë, informacion për shoqërinë në tërësi brenda dhe jashtë vendit.  Asistencë për punën e drejtorive të Zyrës së Komisionerit.
Intensifikim i marrëdhënieve me organizatat në të cilat jemi të anëtarësuar. Vijimi i bashkëpunimit në kuadër të forumeve dhe organizmave ndërkombëtare në fushën e	Bashkëpunimi dhe komunikimi me organizatat e ndryshme ndërkombëtare të fushës së veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.	Gjatë vitit.	Shkëmbim eksperience, informacioni, praktikash dhe forcim kapacitetesh.  Raporte periodike.

<p>mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtës për informim, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Asambleja Globale e Privatësisë (GPA), Komiteti Ekzekutiv, Nënkomiteti i Drejtimit Strategjik (SDSC).</li> <li>- Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Grupi i Punës për të Ardhmen e Konferencës Evropiane.</li> <li>-Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC), angazhimi për anëtarësimin në Komitetin Ekzekutiv të saj.</li> <li>- Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.</li> <li>- Komiteti Konsultativ i Konventës 108 (Komiteti T-PD).</li> <li>- Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit).</li> <li>- Shoqata Frankofone e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP).</li> <li>- Rrjeti i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA).</li> </ul>			<p>Opinione mbi akte të miratuara.</p>
--	--	--	--

<p>Koordinim i punës me donatorët për projektet/programet e BE-së dhe ndihmës së huaj për jetësimin e projekteve që synojnë rritjen e kapaciteteve administrative dhe adoptimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.</p>	<p>Programim, aplikim dhe zbatim teknik të projekteve dhe/ose programeve të asistencës nga fondet IPA dhe/ose donatorë të ndryshëm për të cilat Zyra e Komisionerit është përfituese.</p> <p>Koordinim me institucionet/organizmat përgjegjës, me qëllim sigurimin e zbatimit në kohë të projekteve nën fondet IPA, dhe/ose donatorë të tjerë dhe përgatitjen e raporteve periodike për zbatimin teknik të tyre.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Përfitimi dhe zbatimi i projekteve që synojnë rritjen e kapaciteteve administrative dhe adoptimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre.</p>
<p>Bashkëpunim dhe koordinim me gjithë komponentët e drejtorive.</p>	<p>Ndjekje dhe zhvillim i procedurave të brendshme administrative.</p> <p>Dhënia e mendimeve profesionale në çdo vendimmarrje institucionale përpara miratimit.</p> <p>Finalizim i çdo akti të brendshëm për miratim nga titullari.</p> <p>Realizon përkthime të ndryshme në gjuhë të huaja të dokumenteve të vlerësuara nga Komisioneri, në funksion të nevojave të Zyrës së Komisionerit.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Akte rregullatore të brendshme.</p>

### DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	PRODUKTI
<p>Funksionimi i strukturës së Zyrës së Komisionerit, në zbatim të Vendimit nr. 84/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Rishikimi i strukturave të brendshme pas miratimit të projektligjeve.</p> <p>Publikimi i planit të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022.</p> <p>Publikimi dhe ndjekja e procesit të rekrutimit, në respektim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (sipas llojit të procedurave) për vendet e deklaruara vakante.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>3 mujori i parë i vitit</p>	<p>Strukturë e Zyrës së Komisionerit e plotësuar dhe e konsoliduar.</p>



	<p>Efiçensë dhe transparencë gjatë ekzekutimit të buxhetit, nëpërmjet organizimit të takimeve periodike të Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe dhënies së informacioneve në kohë për vendimmarrje.</p> <p>Ndjekja e procesit të implementimit dhe përfshirjes në hedhjen e të dhënave financiare në sistemin të planifikimit, zbatimit, monitorimit të buxhetit (AFMIS) <i>(Nëse ky sistem do të përshatet teknikisht me detyrimet e ligjit përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale)</i>.</p> <p>Marrja e masave për uljen e nivelit të ndikimit të tyre, takime periodike të GMS, në funksion të plotësimin e objektivave dhe indikatorëve konkretë, për çdo proces të cenuar.</p> <p>Raportim në fund vit mbi gjendjen e risqeve, humbje efektiviteti, ndikimi gjatë vitit, apo evidentimi i risqeve të reja me influence të lartë në plotësimin e objektivave dhe indikatorëve konkretë.</p> <p>Përgatitja e Pasqyrave Financiare të vitit 2022, miratimi i tyre dhe dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Raportimi periodik i shpenzimeve buxhetore të kryera për vitin aktual.</p> <p>Rakordimi i të ardhurave të mbledhura nga dega e thesarit, në mënyrë vullnetare apo nga shërbimi i kontraktuar përmbarimor.</p>	<p>3 mujori i parë i viti 2022</p> <p>Çdo 4 muaj</p> <p>Çdo 4 muaj</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit.</p>	<p>Raporte realizimi transparente dhe të publikuara.</p> <p>Dokument i konsultuar i PBA 3-vjeçar.</p> <p>Përditësim i të dhënave financiare.</p> <p>Raportim periodik.</p> <p>Raportim vjetor.</p>
--	---	---	--

		Gjatë vitit.	Evidentimi i të ardhurave nga sanksionet administrative.
Forcimi dhe zhvillimi profesional nëpërmjet kualifikimit të thelluar të kapaciteteve institucionale.	Analizë vlerësimi (VNT) dhe përcaktimi i planit të trajnimit në përputhje me procesin e vlerësimit të rezultateve.	Gjatë vitit	Programi vjetor i trajnimit të vazhdueshëm.
	Hartimi dhe zbatimi i planit të trajnimit, për të mbështetur angazhimin e punonjësve dhe zhvilluar njohuritë organizative, duke mundësuar arritjen e objektivave institucionale.	Gjatë vitit	Staf i trajnuar në nivel profesional/statistika.
	Pjesëmarrje aktive ose online në trajnimet e ofruara nga ASPA dhe/ose organizata publike/jopublike vendase dhe të huaja.		
	Forcimi i bashkëpunimit me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për përfshirjen në kurrikulën e trajnimeve të detyrueshme/vazhdueshëm të objektit të veprimtarisë së institucionit për nëpunësit civil të çdo niveli.	Gjatë vitit	Trupa e trajnerëve e miratuar dhe kontraktuar.
Krijimi i Trupës së Trajnerëve në bashkëpunim me organizma profesionale dhe akademike.			

<p>Përmirësimi i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit, për të shmangur rreziqet e mundshme nga sulmet apo hyrjet e paautorizuara në sistemin TIK.</p>	<p>Mbështetja me teknologji informative e të gjitha aktiviteteve dhe proceseve të punës, nëpërmjet vlerësimit të gjendjes, identifikimit, projektimit të digjitalizimit, sisteme/platforma të reja, përmirësim e mirëmbajtje e databazave elektronike dhe pajisjeve ekzistuese.</p> <p>Analizë e risqeve të funksionimit të brendshëm të sistemeve të instaluara, në funksion të mirë administrimi, sigurisë së të dhënave dhe infrastrukturës.</p> <p>Realizimi i planit të digjitalizimit për tre vite prioritetive të shpenzimeve kapitale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mirëmbajtja e Regjistrit Elektronik të Kërkesave për Informacion;</li> <li>- <i>UP grade</i> i portalit pyetshtetin.al;</li> <li>- Program aplikativ për automatizimin e proceseve të punës të Zyrës së Arkiv-Protokollit;</li> <li>- Regjistri Elektronik i Subjekteve Kontrolluesve;</li> <li>- Digjitalizim i Programit të Transparencës;</li> <li>- Instalimi dhe vënia në punë e pajisjeve dhe sistemeve;</li> <li>- <i>UP grade</i> të Infrastrukturës TIK, shtimi i pajisjeve të reja për të përmirësuar kapacitetin, duke garantuar sigurinë e infrastrukturës netëork në institucion duke integruar</li> </ul>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Kushte optimale pune.</p> <p>Infrastrukturë e përmirësuar/software të siguruar.</p>
--	---	--------------------	--



modulet e menaxhimit si: *Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve si dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt, të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet teknologjike;*

- Implementimi i zgjidhjeve për backup-et për të mbështetur platformën e shërbimeve dhe misionin kritik të aplikimeve të TIK-së, sipas parametrave bashkëkohorë, përfshirë edhe pajisjet ekzistuese, për të garantuar funksionimin e infrastrukturës kompjuterike si në kushte normale ashtu dhe në kushte emergjence, duke rritur sigurinë në nivel rrjeti, si dhe në nivel të dhënash;
- Menaxhimi i qendëruar i përdoruesve nëpërmjet *Domain controller* lokal.

Evidentimi i risqeve të mundshme të kufizimit apo mosrealizimit të sigurimit dhe pajisjeve *hardware* dhe *software*.

Përmirësimi dhe implementimi i lidhjes software-it ekzistuese IT/HRMIS/ADMINISTRATA.AL/ ALPHACLOUD(kontabilitetit)/IPSI,AMFIS/FISKALIZIM, për trajtimin efikas të të dhënave dhe përfitimin e raporteve online.

Ndjekja e procedurave të prokurimit të shpenzimeve kapitale (investime). Hartimi i planit të detajuar të implementimit të pajisjeve *hardware* dhe *software*, pas përfundimit të procedurave konkurruese dhe lidhjes së kontratave respektive me operatorët fitues.

<p>Përditësimi i faqes zyrtare online të KDIMDP-së me shërbime të reja për publikun, si dhe përmirësimin e rubrikave të saj të transparencës dhe komunikimit.</p>	<p>Rikonceptim dhe përditësimi i faqes zyrtare të institucionit dhe ndërfaqes pyetshtetin.al.</p> <p>Pasqyrim transparent i aktivitetit të Zyrës së Komisionerit.</p> <p>Ndjekja dhe zbatimi i politikave të sigurisë së informacionit, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve.</p> <p>Botim/publikim i materialeve informuese dhe/ose ndërgjegjësuese.</p> <p>Monitorimi dhe përditësimi i programit të transparencës me materiale të përditësuara.</p> <p>Raportime javore nga çdo drejtori për materialet e përpunuara për publikim.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Faqe zyrtare web e përditësuar.</p>
<p>Përpunim i dokumentacionit të arkivës së institucionit.</p>	<p>Vazhdim i përpunimit të dokumenteve të institucionit të cilat i përkasin viteve 2010-2011 dhe dorëzimi i tyre (RHK) pranë institucionit të Arkivit Qendror Shtetëror.</p> <p>Kryerja e procesit të inventarizimit të aseteve/aktiveve të institucionit çdo vit dhe nxjerrja e akteve sipas rezultatit.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Arkiv dokumentacioni e organizuar sipas parashikimeve ligjore.</p>
<p>Vazhdimi i zbatimit të masave të marra në kohë për përballimin me sukses të situatës së pandemisë Covid-19.</p>	<p>Marrja e masave të përgjithshme të higjienës, maska, dezinfektantët me bazë alkooli si dhe distancimi social në institucion.</p> <p>Dizinfektimi i ambienteve.</p>	<p>Gjatë vitit.</p>	<p>Parandalimi i përhapjes së Covid 19 dhe siguria e shëndetit në punë e stafit.</p>